

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6386
E premte, 13 gusht 2021
çmimi 0.40 €

Në dy vjetët e fundit
mbi 200 mjekë janë
larguar nga Kosova | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KUVENDI I KOSOVËS KA MBYLLUR TË ENJTEN PUNIMET E SESIONIT PRANVEROR

ME PAK LIGJE TË MIRATUARA KUVENDI SHKON NË PUSHIM | FAQE 4-5



Kuvendi i Kosovës të enjten ka mbyllur punimet e sesionit pranveror. Institucioni më i lartë legjislativ në vend ka shkuar në pushim, por nuk është treguar

shumë efikas për miratimin e ligjeve gjatë kësaj periudhe kohore. Përfaqësuesit e opozitës dhe të shoqërisë civile kanë thënë se ky ka qenë një prej sesioneve më të

dobëta në historinë e parlamentarishtet. Ndërsa përfaqësuesit e shumicës parlamentare kanë thënë se gjatë këtij sesioni është treguar se demokracia funksionon në vend

AKTUALE



KUVENDI DHE GLSP-ja
NËNSHKRUAJNË MEMORANDUM
BASHKËPUNIMI | F. 3

POLICIA NË FERIZAJ, AKSION
NDAJ SHOFERËVE NËN NDIKIM TË
ALKOOLIT | F. 6

HAZIRI PRET NJË DELEGACION TË
BASHKATDHEARËVE NGA
BRITANIA E MADHE | F. 6

EKONOMI

VLORA SPANCA EMËROHET
AUDITORE E PËRGJITHSHE E
REPUBLIKËS SË KOSOVËS | F. 8

HAJDARI: JANË VËREJTUR
RASTE TË RRRITJES
SË ÇMIMEVE TË PRODUKTEVE
TË KONSUMIT | F. 8

**Konstituohet
Komisioni
i përbashkët
Parlamentar për
Stabilizim-Asociim
BE - Kosovë | FAQE 5**



**Kosova kërkon
dëshmi të vaksinimit
nga 20 gushti | FAQE 6**

Kartela e Vaksinimit për COVID-19
Ju lutem mbani këtë kartelë me vete si dëshmi për vaksinimin tuaj!

Mësimi	Emri	Numri personal
Data e lindjes	Numri i pasaportës	
Vakcina	Emri i produktit Numri serit	Data e vaksinimit Ekipi mjekësor i cili ka dhënë vaksinën
Data e parë	AstraZeneca CTMAV022	10.04.2021 01:13 Nisrullahi ZAHIRI LUCI
Data e dytë		
Typit		



SPORT

FFK-ja NDIHMEN KLUBET E
LIGËS SË DYTË DHE LIGËS SË
TRETË | F. 13

MESSI MBAN STËRVITJEN E
PARË TE PSG-ja | F. 12

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.PK.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Gjermania frikësohet se mijëra persona kanë marrë ujë të kripur në vend të vaksinës



BERLIN, 12 GUSHT - Autoritetet në veri të Gjermanisë u kanë kërkuar më shumë se 8 000 personave që të vaksinohen sërish kundër koronavirusit, pasi një infermiere dyshohet se u ka dhënë atyre ujë me kripë në vend të dozës së vaksinës.

Policia është duke hetuar veprimet e infermieres në një qendër vaksinimi në Friesland, transmeton BBC.

Fillimisht është besuar se vetëm gjashtë persona kanë marrë ujin me kripë në muajt mars dhe prill. Shumica e personave që besohet se kanë marrë këtë substancë të padëmshme janë mbi moshën 70-vjeçare, të cilët hyjnë në kategorinë e rrezikuar nga pandemia.

Inspektori Peter Beer është cituar të ketë thënë, sipas së përditshmes gjermane "Süddeutsche Zeitung", se infermierja 40-vjeçare ka shpërndarë edhe "informacion kritik për koronavirus" nëpër rrjetet sociale, duke kritikuar kufizimet e qeverisë që kanë synuar ta ndalin virusin.

Transmetuesi rajonal gjerman NDR ka raportuar se 8 557 personave u është kërkuar ta përsëritin vaksinimin dhe deri më tani rreth 3 600 terminë të reja janë konfirmuar.

Në muajin prill infermierja e ka pranuar se u ka dhënë gjashtë personave ujin e kripur, për të fshehur faktin se e ka fshehur në dysheme dozën e vaksinës.

Mirëpo teksa hetimet janë zgjeruar, është kuptuar se më shumë persona mund të kenë marrë këtë substancë, në vend të vaksinës së prodhuar nga kompania "Pfizer/BioNTech".

Policia nuk ka hedhur poshtë mundësinë që ndonjë motiv politik ka nxitur veprimet e infermieres, ndonëse avokatët e saj kanë hedhur poshtë diçka të tillë.

Gjermania është përballur disa herë me protesta kundër vaksinimit.

Grupet e ekstremist të djathtë janë në mesin e atyre që kanë refuzuar të dhënat zyrtare dhe konkluzionet rreth Covid-19, sëmundjes që shkakton koronavirusin.

Mohimi i gjenocidit në Srebrenicë do të fshihet nga rrjetet sociale

SARAJEVË, 12 GUSHT - Kompanitë "Twitter" dhe "Google" kanë konfirmuar për "Radion Evropa e Lirë" se kanë në plan që në platformat e tyre të heqin përmbajtjen që e mohon gjenocidin në Srebrenicë të Bosnje dhe Hercegovinës.

Ishte Instituti i Kërkimit të Gjenocidit në Kanada (IGK) i cili së fundi u dërgoi një kërkesë kompanive të teknologjisë "Twitter" dhe "YouTube" për ta ndaluar mohimin e gjenocidit të Srebrenicës në platformat e tyre.

Drejtori i Institutit, Emir Ramiq, i tha "Radion Evropa e Lirë" se IGK i përcjellë dhe mban shënime të

përmbajtjes në rrjetet sociale dhe bazuar në të dhënat që ka, shumica e postimeve që ofendojnë viktimat e Srebrenicës vijnë nga Serbia, por ka edhe nga Rusia, Franca dhe vende të tjera. Ramiq ende nuk ka marrë një përgjigje nga ana e këtyre kompanive në kërkesën që u ka dërguar më 30 korrik.

Ai, megjithatë, shpreson në një përgjigje pozitive pasi, sipas tij, "dy rrjetet sociale tashmë kanë hequr disa përmbajtje që nxitin urrejtjen ndaj tjetrit, fyejnë viktimat e Holokaustit dhe, në raste individuale, viktimat e gjenocidit të Srebrenicës".

Sa i takon kërkesës së Institutit për Hulumtime të Gjenocidit, kompanitë "Twitter" dhe "YouTube" thonë se politikën e tyre janë të përcaktuara qartë dhe se "ndalojnë çdo gjuhë urrejtjeje".

Në përgjigjen për REL-in, "Google", e cila ka në pronësi platformën e videove "YouTube", thotë se do ta heqë të gjithë përmbajtjen që shkel rregullat e vendosura kundër përhapjes së gjuhës së urrejtjes.

Gjatë luftës së viteve 1990 forcat serbe vranë mbi 8 000 burra dhe djem myslimanë në Srebrenicë.

Vrasjet u njohën si gjenocid nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në Hagë.



Zelanda e Re nuk i hap kufijtë këtë vit



WELLINGTON, 12 GUSHT - "Zelanda e Re do të mbajë të mbyllur kufijtë deri të paktën në fund të këtij viti", ka thënë kryeministrja Jacinda Ardern. Ajo ka pohuar se si shtet ende nuk janë në gjendje të rihapen plotësisht. "Kur të lëvizim në drejtim të ndryshimit të masave duam ta bëjmë me sa më shumë siguri që të jetë e mundur", ka deklaruar Ardern.

Zelanda e Re shihet si një nga vendet më të suksesshme në botë në kontrollin e pandemisë së Covid-19. Vendi ka regjistruar vetëm 26 vdekje në një popullsi prej pak më pak se pesë milionë njerëzish.

Vitin e ardhshëm, kur vendi të rihapet, udhëtarët nga vendet me rrezik të ulët që janë të vaksinuar, sipas kryeministres, do të jenë në gjendje ta vizitojnë

Zelandën e Re, pa pasur nevojë të karantinës, ndërsa ata nga vendet me rrezik më të lartë do të duhet të izoloohen ose të hyjnë në karantinë për 14 ditë. Ajo ka theksuar se kjo strategji është mënyra më e mirë për ta mbajtur koronavirusin e ri jashtë Zelandës së Re. Prioritet i autoriteteve të këtij vendi është vaksinimi i popullsisë deri në fund të vitit 2021.

Disa të vdekur nga rrëzimi i helikopterit në Rusi

MOSKË, 12 GUSHT - Tetë persona kanë vdekur dhe dy të tjerë janë lënduar rëndë nga rrëzimi i një helikopteri turistësh në Rusi. Në helikopter ishin 16 persona. Tetë prej tyre janë gjetur të gjallë

dhe dy prej tyre janë në kujdes intensiv për shkak të lëndimeve të marra. Helikopteri, i prodhuar në vitin 1984, drejtohej nga një transportues privat vendas, Vityaz-Aero, i cili është në

bashkëpronësi me Igor Redkin, një biznesmen milioner i cili është gjithashtu ligjvënës rajonal. Aksidenti ndodhi në Gadishullin Kamçatka të Rusisë.



Kosova kërkon dëshmi të vaksinimit nga 20 gushti

REPUBLIKA E KOSOVËS - MINISTRIA E SHËNDETËSISË
REPUBLIKA KOSOVA - MINISTARSTVO ZDRAVLJA

Kartela e Vaksinimit për COVID-19

Ju lutem mbani këtë kartelë me vete si dëshmi për vaksinimin tuaj!

Mbiemri	Emri	Numri personal	
Data e lindjes		Numri i pacientit	
Vaksina	Emri i produktit Numri serik	Data e vaksinimit	Ekipi mjekësor i cili ka dhënë vaksinën
Doza e parë	AstraZeneca CTMAV522	10.04.2021 11:17	Naim Sveçla Naim Sveçla ZAHIDE UKA
Doza e dytë			
Tjetër			

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 12 GUSHT - Qeveria e Kosovës ka miratuar të enjten masat e reja për luftim të pandemisë Covid-19. Në mesin e masave është përfshirë edhe dëshmia për vaksinim kundër këtij virusi për të hyrë në klube të natës, diskoteka, dasma dhe ahengje të tjera familjare me mbi 100 persona, nga data 20 gusht deri më 10 shtator. Në mungesë të dëshmisë për vaksinim, duhet të paraqitet testi

negativ për koronavirus jo më i vjetër se 72 orë, testi antigjen jo më i vjetër se 48 orë, ose dëshmia për tejkalim të koronavirusit brenda 180 ditëve. Dëshminë për vaksinim duhet ta kenë edhe personat që punojnë në këto biznese dhe kanë kontakt me njerëz. Bizneset do të detyrohen që të angazhojnë dikë që t'i kontrollojë dokumentet e kërkuara për të fituar qasje nëpër organizime. Personat nën moshën 18-vjeçare nuk janë të detyruar të prezantojnë këtë dëshmi, përveç

rasteve kur hyjnë në klube të natës. Bartja e maskës është bërë e obligueshme, përveç rasteve kur një person ec vetëm në ambient të jashtëm, gjatë ngasjes së automjetit, vetëm, apo në grup me jo më shumë se katër persona, apo gjatë ushtrimeve fizike. Shërbimet e gastronomisë do të mund të punojnë me 50 përqind të kapacitetit në ambientet e mbyllura dhe 70 përqind të kapacitetit në ambientet e hapura.

Edhe dy viktima dhe 1 009 raste të reja me Covid

Autoritetet shëndetësore në Kosovë kanë regjistruar të enjten dy viktima me koronavirus. Viktimat janë nga Suhareka dhe Vitia. Në 24 orët e fundit janë regjistruar edhe 1 009 raste të infektimit, pas testimit të 6 784 mostrave. Pjesa më e madhe e të infektuarve janë të moshave nga 20 deri në 29 vjeç, përkatësisht 269 persona. Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se më 12 gusht janë shëruar 82 pacientë nga sëmundja Covid-19, derisa raste aktive janë 4 414. Prej 13 marsit 2020, kur janë regjistruar rastet e para të

infektimit, autoritetet shëndetësore në Kosovë kanë regjistruar 112 653 pacientë me këtë virus. Prej këtyre, 2276 kanë vdekur. Në Kosovë tashmë ka nisur programi i vaksinimit masiv kundër koronavirusit. Në këtë vend ka vaksina të prodhuesve "Pfizer/BioNTech" dhe "AstraZeneca". Në 24 orët e fundit janë vaksinuar 17 986 persona. Të vaksinuar me të dyja dozat janë 183 240 persona, derisa sipas autoriteteve 539 752 vaksina janë dhënë në total në Kosovë.

Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në mbledhjen e së enjtes ka diskutuar për situatën e shkaktoara nga pandemia Covid-19. Anëtarë të komisionit shprehën shqetësimin e tyre lidhur me rritjen e rasteve të infektimit me Covid, ndërsa theksuan nevojën që vaksinimi i popullatës të

bëhet edhe gjatë fundjavës. Pas diskutimeve të deputetëve, kryetarja Kollçaku ka propozuar që komisioni t'i drejtohet Ministrisë së Shëndetësisë që t'i rrisë raportimet ditore dhe të informojë për masat e reja që po ndërmerren për parandalimin e përkeqësimit të situatës me Covid-19.

Kuvendi dhe GLSP-ja nënshkruajnë memorandum bashkëpunimi



PRISHTINË, 12 GUSHT (ER) - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca dhe drejtoresha ekzekutive e Grupit për Studime Juridike dhe Politike (GLPS), Arbëreshë Loxha-Stublla, kanë nënshkruar të enjten një memorandum bashkëpunimi. Qëllimi i këtij memorandum është mundësimi i zbatimit të projektit të titulluar: "Rritja e efikasitetit - monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të parimeve të sundimit të ligjit në Kosovë, në bazë të listës së kontrollit të sundimit të ligjit të Këshillit të

Evropës", i financuar nga Ambasada e Mbretërisë së Holandës në Kosovë, në kuadër të programit "Matra" dhe zbatuar nga GLPS-ja. Ky projekt synon ta bëjë matjen e zbatimit të "Listës së parimeve" në kuadër të Këshillit të Evropës dhe të kontribuojë në përmirësimin e sundimit të ligjit në Kosovë përmes metodologjisë së krijuar nga ekspertët juristë në GLPS. Memorandumi, po ashtu, përcakton veprimet e përbashkëta ndërmjet

Kuvendit të Kosovës dhe GLPS-së sa i përket implementimit të këtij projekti si dhe përgjegjësitë e secilës palë, me synim final të dhënies së qasjes së plotë në të dhëna publike, të nevojshme për zbatimin e projektit në përputhje me legjislacionin përkatës për qasje në dokumentet publike dhe klasifikim të informacionit. Kuvendi i Republikës së Kosovës angazhohet për transparencë dhe bashkëpunim konstruktiv me shoqërinë civile.

Kurti priti në takim kontingjentin e FSK-së që ndihmoi për shuarjen e zjarreve në Shqipëri

PRISHTINË, 12 GUSHT (ER) - Pjesëtarët e Task-Forcës Reaguese të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), të cilët morën pjesë në operacionin për shuarjen e zjarreve në Republikën e Shqipërisë, u mirëpritën në një takim falënderues nga kryeministri Albin Kurti bashkë me ministrin e Mbrojtjes, Armend Mehaj.

Më 9 gusht, me urdhër operacional, ata kishin zbatuar në Republikën e Shqipërisë si pjesë e kontingjentit të përbërë nga tri skuadra të zjarrfikjes dhe shpëtimit të Gardës Kombëtare, si dhe një ekip të Kompanisë për Operacione me Civilë. "Gatishmëria, kontributi dhe angazhimi juaj meriton

vlerësimin dhe mirënjohjen më të lartë nga të gjithë ne", ka deklaruar kryeministri Kurti në takim. Ai ka theksuar se Qeveria e Kosovës i qëndron pranë zotimit të saj për të dhënë vëmendjen e merituar Forcës së Sigurisë, duke i ngritur kapacitetet profesionale në shërbim të misionit të saj.





KUVENDI I KOSOVËS KA MBYLLUR TË ENJTEN PUNIMET E SESIONIT PRANVEROR

Me pak ligje të miratuara Kuvendi shkon në pushim

Kuvendi i Kosovës të enjten ka mbyllur punimet e sesionit pranveror. Institucioni më i lartë legjislativ në vend ka shkuar në pushim, por nuk është treguar shumë efikas për miratimin e ligjeve gjatë kësaj periudhe kohore. Përfaqësuesit e opozitës dhe të shoqërisë civile kanë thënë se ky ka qenë një prej sesioneve më të dobëta në historinë e parlamentarizmit. Ndërsa përfaqësuesit e shumicës parlamentare kanë thënë se gjatë këtij sesioni është treguar se demokracia funksionon në vend

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 12 GUSHT - Me seancën e së enjtes, Kuvendi i Kosovës ka mbyllur punimet e sesionit pranveror. Pas përfundimit të votimeve për seancën e fundit, kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, ka thënë se ky institucion zyrtarisht shkon në pushim deri në sesionin vjeshtor.

Deputetët e opozitës kanë lavdëruar punën e Kuvendit,

ndërsa ata të opozitës dhe shoqëria civile kanë kritikuar punën e mazhorancës parlamentare. Sipas këtyre të fundit, Kuvendi nuk ka qenë efikas në punën e tij. Ata kanë thënë se për pesë muaj Kuvendi ka miratuar pak ligje.

Shefi i grupit parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Abelard Tahiri, ka thënë se ky sesion ka qenë më i dobëti në historinë e parlamentarizmit të Kosovës. Pas përfundimit të seancës, në një konferencë për

media ai ka vlerësuar se ky Kuvend për pesë muaj punë ka miratuar vetëm katër ligje. "Sot Kuvendi i Kosovës e mbylli sesionin pranveror. Me atë që kemi parë në këta pothuajse pesë muaj, kjo është performanca më e dobët parlamentare e udhëhequr nga Lëvizja Vetëvendosje. Gjatë këtyre pesë muajve ky institucion ka miratuar vetëm katër ligje. Edhe këto katër ligje nuk kanë pasur të bëjnë asgjë me projektet e tyre të cilat këta i

kanë proklamuar gjatë fushatës së tyre zgjedhore", ka thënë Tahiri.

Ai ka bërë me dije se gjatë kësaj periudhe kohore Kuvendi ishte shndërruar në ndërmarrje të punësimeve familjare. "Gjatë tërë kësaj periudhe Kuvendi i Kosovës, i udhëhequr nga kjo mazhorancë parlamentare, mund të themi lirisht se ishte shndërruar në një ndërmarrje të madhe për punësime familjare. Keni qenë dëshmitarë të asaj se këtu janë sjell dhe votuar shumë familjarë të kryeministrit, të zëvendëskryeministrave, të këshilltarëve të kryeministrit, të deputetëve të LV-së, të ministrave e kështu me radhë. Degradim më të madh prej themelimit të këtij institucioni nuk ka pasur asnjëherë sesa ka pasur këta katër muaj", ka deklaruar Tahiri. Sipas tij,

degradimi më i madh ka ndodhur në seancën e fundit parlamentare. "Sot ishte kulimi. Në krye të Zyrës së Auditorit Gjeneral vjen me shantazh motra e këshilltarit të kryeministrit të Kosovës. Ju mund të imagjinoni se nga sot raportet e auditorit do të shkruhen nga Zyra e Albin Kurtit. Kjo është një fatkeqësi e madhe, sepse auditori është një institucion tepër i rëndësishëm për denoncimin dhe abuzimin e parasë publike", ka thënë Tahiri.

Edhe drejtori ekzekutiv i Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD), Ehat Miftaraj, nuk është shprehur i kënaqur me punën e kësaj legjislature. "Kjo legjislaturë në raport me legjislaturat e kaluara që nga shpallja e pavarësisë dallon për faktin se partia në pushtet, e vetme, pothuajse për herë të

LV-ja dhe PDK-ja bëhen bashkë kundër 'Listës Serbe' në Artanë, duan ndihmë edhe nga partitë e tjera



PRISHTINË, 12 GUSHT (ER) - Kryetari i Qendrës së Lëvizjes Vetëvendosje në Artanë, Abdyl Gashi, ka bërë me dije se me PDK-në janë marrë vesh që të mbështetin një kandidat të përbashkët që vjen nga shoqëria civile në zgjedhjet për kryetar të komunës duke bashkuar kështu forcat kundër "Listës Serbe". Ai në një shkrim publikuar në llogarinë e vet në "Facebook" ka kërkuar edhe nga subjektet e tjera politike mbështetjen e një

kandidati të shoqërisë civile. "Lëvizja Vetëvendosje në Artanë, duke u bazuar në specifikat e komunës së Artanës, ku në qeverisje lokale kemi Listën Serbe, ne si Lëvizje kemi vlerësuar që një unitet i subjekteve politike shqiptare është shumë i nevojshëm", ka shkruar ai. Gashi ka shkruar se i kanë takuar të gjitha subjektet politike në Artanë, por deri më tani kanë marrë mbështetjen vetëm të

PDK-së. "Si kryetar i Qendrës së Lëvizjes në Artanë kam takuar të gjithë përfaqësuesit e subjekteve politike në Artanë për t'u përbashkuar rreth kësaj kauze. Në këto takime Lëvizja Vetëvendosje ka propozuar që të mbështetet një kandidat për kryetar apo kryetare të komunës nga shoqëria civile. Deri tani nuk kemi gjetur mbështetje nga subjektet e tjera, në përjashtim të Partisë Demokratike të Kosovës", ka shkruar Gashi.

Policia në Ferizaj, aksion ndaj shoferëve nën ndikim të alkoolit

FERIZAJ, 12 GUSHT (ER) - Drejtoria Rajonale e Policisë në Ferizaj ka vazhduar aktivitetet për parandalimin e aksidenteve në komunikacion, duke ndërmarrë një aksion të gjerë për t'i kontrolluar shoferët e automjeteve në rast se drejtojnë automjetet e tyre nën ndikimin e alkoolit. "Nga data 01.08.2021-11.08.2021 policia ka shqiptuar 38 fletëparaqitje ndaj shoferëve

që kanë drejtuar automjetet nën ndikimin e alkoolit, njëkohësisht këtyre drejtuesve u janë hequr pikët negative dhe masa mbrojtëse, ndalim drejtimi i automjetit për disa muaj. Vozitja e automjetit nën ndikimin e alkoolit përfshinë një nga rreziqet serioze për sigurinë në komunikacionin rrugor, andaj policia do të vazhdojë aktivitetet e tilla, me masa të shtuara ndëshkuese ndaj të

gjithë shkelësve të Ligjit të Komunikacionit, me të vetmin qëllim ngritjen e nivelit të sigurisë në komunikacion dhe parandalimin e aksidenteve rrugore", ka njoftuar Policia e Kosovës.

Drejtoria Rajonale e Policisë në Ferizaj ka ftuar qytetarët që të bashkëpunojnë me policinë për të gjitha kundërvajtjet që shkaktohen në komunikacion.



Haziri pret një delegacion të bashkatdhetarëve nga Britania e Madhe



GJILAN, 12 GUSHT (ER) - Në vazhdim të pritjes në shenjë nderimi për kontributin e bashkatdhetarëve, kryetari i komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka pritur të enjten një delegacion të mërgatës nga Britania e Madhe, i udhëhequr nga Selami Sylejmani dhe Alban Nuredini.

Kryetari Haziri, pasi u uroi mirëseardhje, ka falënderuar ata për kontributin e madh që kanë dhënë për Kosovën dhe Gjilanin në vazhdimësi. "Ju uroj mirëseardhje në vendlindje

dhe ju falënderoj për kontributin tuaj për vendin në mënyrë permanente edhe në kohën e para luftës, por edhe tani. Shumë prej bashkatdhetarëve tanë kudo që jetojnë në botë, përpos që i mbështetin financiarisht familjet e tyre, janë edhe investitorë në Gjilan e nëpër komunat e tjera, duke krijuar vende të reja të punës. Për mua ju jeni heronjtë tanë të gjallë", ka thënë Haziri.

Ai ka theksuar faktin se një Gjilan i vogël sot jeton në

shtetet perëndimore duke shtuar se komuna u krijon mundësi dhe lehtësira në kuadër të ligjit dhe janë të lirë të punojnë dhe investojnë në të gjitha fushat, pa procedura burokratike.

Në emër të delegacionit të bashkatdhetarëve nga Britania e Madhe kanë folur, Selami Sylejmani dhe Alban Nuredini, të cilët kanë falënderuar kryetarin Haziri për pritjen dhe e kanë përgëzuar për punën e madhe për t'ua bërë jetesën më të mirë qytetarëve.

Filloi asfaltimi i rrugës që lidh tri lagje të fshatit Banjë

MALISHEVË, 12 GUSHT - Në fshatin Banjë të komunës së Malishevës ka filluar asfaltimi i rrugës së gjatë afër dy kilometra e cila lidh lagjet Telakt e Malit, Shala dhe Limaj, si dhe me rrugën kryesore në fshat. Asfaltimin e kësaj rruge, e cila ka qenë kërkesë e kahershme e banorëve, e kanë parë edhe nënkryetari i komunës së Malishevës, Hajdin Berisha, drejtori i Urbanizmit, Ahmet Morina, drejtori i Emergjencave, Hafir Rexha dhe shefi i njësisë së

prokurimit, Nuhi Shala, të cilët janë takuar edhe me banorët e lagjeve dhe përfaqësuesit e tyre, përkatësisht përfaqësuesin Hamit Limaj. "Më vjen mirë që kjo rrugë po përfundon së ndërtuari, pasi ka qenë një kërkesë e kahershme e banorëve të këtyre lagjeve, sepse lidh këto lagje dhe shkurton rrugën e lëvizjes. Po ashtu kjo rrugë ka rëndësi të madhe edhe për bujqit, pasi krijohet lehtësi edhe për qasje në pjesën fushës

bujqësore. Ju banorët të Banjës, në veçanti të këtyre lagjeve, ta gëzoni rrugën", ka thënë nënkryetari Berisha.

Drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit, Ahmet Morina, ka sqaruar se rregullimi dhe asfaltimi i kësaj rruge është pjesë e investimeve kapitale që janë duke u realizuar në kuadër të rregullimit të infrastrukturës rrugore dhe kjo rrugë është e gjatë rreth dy mijë metra dhe mundësohet nga buxheti i komunës së Malishevës.



Në dy vjetët e fundit mbi 200 mjekë janë larguar nga Kosova



Prishtinë, 12 gusht - Në dy vjetët e fundit rreth 220 mjekë janë larguar nga Kosova duke kërkuar punë në Gjermani dhe vende të tjera të Bashkimit Evropian (BE). Mbi 150 mjekë të tjerë pritet që të largohen vetëm këtë vit.

Përfaqësues nga Oda e Mjekëve të Kosovës thonë se ky trend i rritjes po thëllon krizën për staf shëndetësor. Sipas tyre, arsyet e largimit të mjekëve nga Kosova kanë të bëjnë me kushtet e këqija të punës, problemet me specializim dhe pagat e ulëta. Paga bruto (e patakshuar) e mjekëve në Kosovë është 610 euro, derisa në Gjermani ata paguhen deri në 4 000 euro.

Një pagë të tillë synon ta marrë edhe Rrezon Nalli nga fshati Krushë e Madhe, i cili ka diplomuar në Mjekësi të Përgjithshme në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" në korrik të vitit 2019. Ky 26-vjeçar nga komuna e Rahovecit, si qindra mjekë të rinj në Kosovë, është duke tentuar të gjejë punë në Gjermani. Ai thotë për "Radion Evropa e Lirë" se pagat e vogla në sektorin e shëndetësisë dhe kushtet jo të mira të punës, kanë ndikuar që ai të mendojë të largohet nga vendlindja. "Të them të drejtën, dëshirën për të shkuar jashtë vendit e kam pasur gati thuajse nga viti i dytë i studimeve në fakultet, gradualisht e kam parë që sistemi shëndetësor është degraduar dhe thjesht nuk e kam gjetur veten si pjesë të këtij sistemi. Më është dashur të sakrifikoja shumë për t'i përfunduar studimet", tha Nalli. Rrezon Nalli ëndërron që të bëhet një ortoped i suksesshëm në

Gjermani. Si student, kishte shkuar në Gjermani në vitin 2017 me vizë pune dhe me t'u kthyer nga atje, kishte filluar të mësojë gjuhën gjermane. "Jam në fazë të pritjes së rezultateve të nivelit B2 (test i gjuhës gjermane), kam hyrë në provim. Diplomën e B1 e kam marrë më herët, mirëpo për ne në mjekësi është e obligueshme niveli B2 i gjuhës, për këtë arsye kam vazhduar kursin", tha Nalli.

Ylber Murtezaj, pronar i një shkolle të gjuhëve të huaja në Kosovë, tha për "Radion Evropa e Lirë", se rreth dy vjet mund të zgjasë kursi për ta mësuar gjuhën në nivelin që kërkohet dhe shuma që duhet të paguar, kalon mbi 1 000 euro. "Niveli bazik mund të sillt rreth 150 euro. Ky nivel përfshin nivelin A1 dhe A2, dy nivelet komplet 200 euro. Pastaj nivelet B1 dhe B2 mund të shkojnë rreth 300 euro, dy nivele 600 euro. Këtu varet edhe forma e ndjekjes së kursit, a është në grup apo në mënyrë individuale", tha Murtezaj.

Rreth 150 mjekë pritet të largohen këtë vit nga Kosova

Për një vit në Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" diplomojnë rreth 150 mjekë të rinj. Sipas Odës së Mjekëve të Kosovës, një numër i përafërt pritet të largohet nga Kosova deri në fund të këtij viti. Pleurat Sejdiu nga kjo Odë tha për "Radion Evropa e Lirë" se shumica e mjekëve që largohen nga Kosova, shkojnë në Gjermani. "Që nga

funksionalizimi i Odës së Mjekëve të Kosovës, tash është viti i katërt, këtë vit ka qenë numri më i madh. Vetëm për 7 muajt e parë kemi pasur 82 mjekë, të cilët kanë kërkuar dokumentin për largim, i cili iu duhet si referencë apo si dokument nga Oda e Mjekëve që nuk kanë ndonjë problem me kodin e etikës profesionale dhe me ligjet në Kosovë", tha Sejdiu.

Ai tha se rreth 220 mjekë janë larguar nga Kosova në dy vjetët e fundit dhe nëse vazhdon ky trend i largimit, Kosova do të përballet me mungesën e mjekëve. "Unë mendoj që brenda pesë vjetëve do ta kemi krizën se trendi shkon edhe tek rritja e numrit të specialistëve të rinj që largohen. Në gjashtëmuajorin e parë kemi pasur 7 specialistë të rinj që janë larguar dhe kjo e keqëson edhe më shumë situatën, kur ne kemi moshën mesatare mbi 50 të mjekëve të punësuar në Kosovë", tha Sejdiu. Sipas Sejdiut, 90 për qind e atyre që largohen nga Kosova janë mjekë të përgjithshëm të sapodiplomuar.

Shëndetësia, IT-ja, gastronomia, inxhinieria dhe bujqësia, më të kërkuarat

Instituti GAP ka bërë dy raporte në vitet e fundit sa i përket emigrimit të qytetarëve të Kosovës drejt vendeve të Bashkimit Evropian.

Jeton Mehmeti nga ky institut tha për "Radion Evropa e Lirë" se nëse trendi i emigrimit të fuqisë punëtore kthehet në përmasat e kohës para pandemisë, sektori i

kujdesit shëndetësor, teknologjisë informative, i gastronomisë, inxhinieria dhe bujqësia rrezikojnë të preken seriozisht nga mungesa e fuqisë punëtore. "Emigrimi i fuqisë punëtore drejt vendeve të BE-së është në rritje. Rregullorja për Ballkanin Perëndimor ka ndikuar dukshëm në rritjen e emigrimit të fuqisë punëtore drejt Gjermanisë. Nga të dhënat që kemi siguruar nga Agjencia Federale e Punësimit e Gjermanisë, del se kosovarët prijnë për nga interesimi për të emigruar", tha Mehmeti.

Lirim Krasniqi nga Organizata Joqeveritare Germin, organizatë kjo që merret kryesisht me çështje të diasporës, tha se shumica e të rinjve nga Kosova që marrin viza të Gjermanisë, shkojnë të punojnë në sektorin e ndërtimitarisë. "Vetëm punëtorët shëndetësorë që shkojnë në Gjermani, përfundojnë duke punuar në të njëjtin sektor, kurse jashtë shëndetësisë ka përzjerje të shumë fushave dhe kryesisht ata që shkojnë në Gjermani përmes këtyre formave të migrimit, përfundojnë në sektorin e ndërtimitarisë", tha Krasniqi.

Ambasada e Gjermanisë: Mbi 50 mijë viza në vitin 2019

Për shkak të pandemisë Covid-19, gjatë vitit 2020 dhe 2021, Ambasada e Gjermanisë në Prishtinë ka mundur të lëshojë viza vetëm për bashkim familjar, për studime dhe kategori të

caktuara të vizave të punës për punëtorë me kualifikim të lartë. Në vitin 2019, sipas një përgjigje të ambasadës dërguar Radios Evropa e Lirë, kjo ambasadë ka lëshuar më shumë se 50 mijë viza.

Prej tyre rreth 36 mijë viza kanë qenë për qëndrime afatshkurtra (viza Schengen), si dhe rreth 15 mijë viza nacionale për qëndrime afatgjata, bashkim familjar, viza pune dhe viza studimi.

Pandemia ndryshoi çdo gjë në vitin 2020. "Për shkak të kufizimeve të udhëtimit të shkaktuara nga pandemia, në vitin 2020 Ambasada e Gjermanisë në Prishtinë i ka lëshuar vetëm 18 000 viza. Këtu përfshihen 8 000 viza afatshkurtra dhe 10 000 viza për qëndrime afatgjata. Shumica e këtyre vizave të lëshuara kanë qenë për qëllime të bashkimit familjar, meqë kjo kategori ka qenë e përjashtuar nga kufizimet e udhëtimit", thuhet në përgjigje. Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), gjithsej 8 724 qytetarë të Kosovës janë larguar gjatë vitit 2020, përfshirë emigrantët legalë dhe ata ilegalë. Pjesa dërrmuese e emigrantëve për vitin 2020 ishin emigrantët legalë. Sipas ASK-së, arsyet e emigrimit legal janë bashkimi familjar, martesat, gjetja e një vendi pune, shpërngulje të përhershme, studime afatgjata me punësim etj. Përveç vendeve të BE-së, një numër i kosovarëve ka emigruar edhe në vende të tjera kryesisht në ShBA, Turqi, Kanada dhe vende të tjera.

Vlora Spanca emërohet Auditore e Përgjithshme e Republikës së Kosovës

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 12 GUSHT - Kuvendi i Kosovës me shumicë votash ka zgjedhur të enjten Vlora Spancën auditore të përgjithshme të Republikës së Kosovës me mandat pesëvjeçar. Pas marrjes së detyrës, auditorja e përgjithshme Vlora Spanca është zotuar se do të vazhdojë të punojë për fuqizimin e rolit dhe ndikimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për rritjen e llogaridhënies dhe transparencës në sektorin publik.

Auditori i deritanishëm, Besnik Osmani, e ka uruar Spancën për marrjen e detyrës së re, duke shprehur besimin që Zyra Kombëtare e Auditimit do të vazhdojë të mbetet një ndër institucionet më të besueshme në Kosovë.

Spanca është auditorja e pestë me radhë që nga themelimi i institucionit të Auditorit të Përgjithshëm në vitin 2003.

Vlora Spanca që nga muaji gusht i vitit 2017 ishte ndihmëauditore e përgjithshme në Zyrën Kombëtare të Auditimit. Ajo ishte përgjegjëse për divizionin e një portofoli të departamenteve

të auditimit, që përfshin: Departamentin e Auditimit të Performancës, Departamentin e Auditimit të Performancës dhe Teknologjisë Informativë, si dhe Departamentin e Auditimit për Prokurimin dhe Menaxhimin e Projektit. Po ashtu, ka qenë përgjegjëse për auditimin financiar të projekteve të financuara nga donatorë të ndryshëm, si Banka Botërore dhe Agjencia Suedeze për Zhvillim. Gjatë periudhës 2017-2019 Spanca ka qenë koordinatore për implementim të projektit të financiar nga Banka Botërore për zhvillimin e kapaciteteve audituese në fushën e prokurimit publik.

Në Zyrën Kombëtare të Auditimit është punësuar në vitin 2007 dhe që nga viti 2009 deri në vitin 2016 Spanca ishte drejtoreshë e Departamentit të Auditimit për auditime të rregullsisë, që përfshin ministrinë dhe agjencitë e pavarura të krijuara nga Kuvendi i Kosovës.

Gjatë periudhës 2015-2016 Spanca ishte përgjegjëse për auditimin e Pasqyrës Vjetore Financiare të Buxhetit të Kosovës. Para se të punësohej në Zyrën Kombëtare të Auditimit, Spanca ka punuar katër vjet me Misionin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë,



për zyrën e zëvendësperfaqësuesit special të sekretarit të përgjithshëm. Ajo ishte përgjegjëse kryesisht për mbështetjen e veprimtarive administrative për zyrat ndërlidhëse me Trupat

Mbrojtëse të Kosovës, strukturën e përkohshme administrative të Kosovës, si dhe për Drejtorinë për Çështje Rurale.

Spanca ka përfunduar studimet universitare për ekonomi në

Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina". Është auditore e certifikuar në sektorin publik dhe është certifikuar si menaxhere e cilësisë së sistemit nga "Quality Austria".

Hajdari: Janë vërejtur raste të rritjes së çmimeve të produkteve të konsumit



PRISHTINË, 12 GUSHT - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, ka thënë se është shqetësuese se muajt e fundit janë vërejtur raste të rritjes së çmimeve, në veçanti për produktet e konsumit. Ajo ka thënë se ngritja e çmimeve për produktet bujqësore, ushqimore dhe atyre industriale është pasojë e çekuilibrit në tregun global. "Është evidente se në muajt e fundit janë vërejtur raste të rritjes së çmimeve, në veçanti për produktet e konsumit dhe kjo është shumë shqetësuese. Mirëpo vlen të theksohet se sa iu përket produkteve të konsumit

për të cilat çmimi i tyre diktohet nga berëza ndërkombëtare dhe çdo lëvizje reflektohet edhe në tregun e Kosovës. Ne të gjithë e dimë se Kosova ka një varësi jashtëzakonisht të madhe në importe, sidomos në importe të produkteve që janë të rëndësishme për konsumin e ekonomive familjare që përfaqëson një pjesë të konsiderueshme të importeve totale të mallrave të konsumit, për të cilat kemi një deficit tregtar mjaft të lartë dhe të vazhdueshëm prej 406 milionë eurosh vetëm për gjashtë muajt e parë të këtij viti", ka thënë ministria Hajdari.

Anulohet festivali "Beerfest" në Kosovë

PRISHTINË, 12 GUSHT (ER) - Në Kosovë është anuluar mbajtja e festivalit të birrës "Beerfest" për shkak të rritjes së rasteve me Covid-19 ditët e fundit. Organizatorët e festivalit njoftuan përmes një postimi në rrjetin social "Facebook" se mbajtja e edicionit të 10 të festivalit është anuluar "pas një vendimi të Policisë së Kosovës ku thuhet se mbajtja

e këtij festivali paraqet rrezik për qytetarët". Kompania që e organizon festivalin, "Modus Event Management", thotë se është pajtuar me këtë vendim, pavarësisht se "Beerfest" nuk dallon në thelb nga aktivitetet dhe festivalet që po mbahen ditët e fundit në Kosovë. "Sido që të jetë, duke e parë edhe rritjen e madhe dhe drastike në ditët e fundit të rasteve me

Covid-19, nuk kemi zgjidhje tjetër veçse të respektojmë këtë vendim dhe ta pezullojmë mbajtjen e 'Beerfest'. Shpresojmë që në të ardhmen e afërt do të kemi ndryshime të rrethanave dhe do të krijohen kushtet për mbajtjen e këtij eventi", është bërë me dije në njoftimin për media të "Modus Event Management".





Panspermia: Teoria yjore për Origjinën e Jetës

Astronomi i famshëm Karl Sagan, tha dikur se çështja e natyrës së jetës në Tokë, dhe pyetja nëse jeta mund të gjendet përtej Tokës, janë dy anët e të njëjtës pyetje. Në rastin e Panspermisë, të dyja pyetjet marrin përgjigje të përmbledhura.

Jeta ekziston përtej Tokës, dhe jeta siç e njohim në planetin tonë jeshil-blu, erdhi nga jashtë atmosferës sonë. Disa objekte qiellore, janë sugjeruar si burimi i jetës në Tokë ngambështetësit e terisë së Panspermisë. Këtu përfshihet Marsi, kometat dhe asteroidët, madje edhe sisteme të tjera yjore.

Idetë e hershme mbi Pansperminë

Panspermia është një ide shumë e vjetër, e cila e ka origjinën të paktën që nga koha e grekëve të lashtë. Disa nga përkrahësit e parë të kësaj hipoteze shkencore në kohët moderne përfshijnë astronomët Fred Hojl dhe Çandra Vikramasing. Edhe pse nuk janë gjetur prova për këtë hipotezë të origjinës së jetës, zbulimet e shekullit të kaluar, e bëjnë më të besueshme Pansperminë.

Këto zbulime përfshijnë dëshmi intriguese, se jeta mund të ketë ekzistuar dikur në Mars. Një linjë që i ka dhënë më shumë besueshmëri kësaj teze, është fakti se dëshmia më e hershme

e padiskutueshme e jetës në dhënat gjeologjike daton rreth 3.8 miliardë vjet më parë, afër fundit të Bombardimit të Rëndë të Vonë (LHB), një periudhë e aktivitetit të madh në sistemin hershëm diellor, ku shkalla e përplasjeve midis trupave planetarë, ishte shumë më e lartë nga sa është sot.

A erdhi jeta në Tokë nga Marsi?

Në vitin 1984, një meteorit u zbulua në rajonin Alan Hills të Antarktidës. Ai u quajt ALH84001, dhe për një dekadë u la në harresë. Por në vitin 1994, analizat gjeokimike dhe mikroskopike, treguan se objekti ishte një meteorit marsian dhe shumë i pazakontë nga tëtjerët.

Shkencëtarët zbuluan se ai përmbante molekula organike komplekse të njohura si hidrokarbure aromatike policiklike (PAH), të cilat shpesh shoqërohen me aktivitet mikrobik. Po ashtu ata gjetën magnetite të përziera me sulfur hekuri. Zakonisht këto 2 minerale zakonisht nuk qëllon të jenë bashkë në prani të karbonateve, në rast se nuk prodhohen nga organizma të gjallë.

Për më tepër, studiuesit zbuluan disa nanostruktura në formë shufre me një pamje të pazakontë, të cilat kishin ngjashmëri me disa lloje bakteresh. Këto tre zbulime brenda meteorit, u cilësuan nga disa shkencëtarë si

prova e mundshme e jetës në planetin e kuq.

Por me kalimin e viteve, shumica e provave që fillimisht dukeshin intriguese, tani konsiderohen të dyshimta, dhe aktualisht favorizohet më shumë hipoteza e një origjinë jo-biologjike të tyre.

Çështja nëse ekziston apo jo jetë në Mars, do të marrë përgjigje nga një mision që është planifikuar të nisë në fillimin e viteve 2030. Ndërkohë, vazhdojnë të mblidhen të dhëna që tregojnë se dikur Marsi ishte një planet më i pastër dhe më i lagësht, dhe se mund të ketë pasur jetë në të kaluarën gjeologjike të largët

Jetë nga kometat apo asteroidet?

Çandra Vikramasing, astronom dhe matematikan në Universitetin e Bakingham, Britani, mendon se jeta ka të ngjarë të jetë formuar në brendësinë e kometave. Ai thotë se trilionobjekte kometike që ka të ngjarë të ekzistojnë në sistemin diellor, ofrojnë shumë më tepër mundësi ku mund të jetë formuar jeta, sesa në mjediset e Tokës së hershme.

Sipas tij është e mundur që një kometë të jetë "infektuar" me jetë, kur ka kaluar nëpër atmosferën e sipërme të një planeti të pasur me jetë. Kjo mund ta lejojë që jeta të implantohet në një kometë pa u formuar në të.

Sigurisht, kjo nuk shpjegon se si u formua ajo jetë. Thjesht e shtyn problemin më larg në kohë, dhe në një trup tjetër planetar.

Një tjetër vend premtues për një origjinë jo-planetare të jetës mund të jenë asteroidët. Ata janë trupa shkëmborë që gjenden kryesisht midis orbitave të Marsit dhe Jupiterit. Shumica e asteroideve, janë ndoshta fragmente të trupave protoplanetarë, që mund të kenë qenë sa madhësia e Vestas, me diametër rreth 530 kilometra.

Shumë asteroidë janë të pasur me lëndë organike, përfshirë aminoacidet. Për më tepër, analiza izotopike e asteroideve tregon se disa asteroidë kanë raporte izotopi deuterium-hidrogjen të ngjashëm me ujin në Tokë, duke e bërë më të mundshme që asteroidet të kenë kontribuar me materiale në Tokë gjatë formimit të saj.

Jetë nga sistemet e tjera yjore?

Në fillim shkencëtarët ishin shumë dyshues nëse mikrobet brenda shkëmbinjve të vegjël, mund t'i mbijetonin distancave të mëdha midis yjeve, sidomos pasi një udhëtim ndër yjor do të zgjaste qindra miliona ose miliarda vjet. Por ky opinion ka ndryshuar me zbulimin kohët e fundit të 2 objekteve ndëryjorë, që kanë kaluar nëpër sistemin tonë diellor.

E pari ishte Oumuamua, që në

gjuhën e Hauait do të thotë "i dërguari i parë nga larg". Ai u zbulua në vitin 2017 nga astronomët duke përdorur një teleskop të Universitetit të Hauait.

Objekti i dytë u zbulua në vitin 2019. 2I/Borisov, ishte shumë i ngjashëm me kometat e sistemit tonë diellor, përveç orbitës së tij hiperbolike.

2I/Borisov dhe Oumuamua u zbuluan vetëm brenda 2 vitesh nga njëri -tjetri. Dhe kjo sugjeron se vizita nga objektet ndëryjore, janë më të zakonshme nga sa mendohej. Kjo ka bërë që shkencëtarët të jenë më të hapur ndaj mundësisë që jeta të udhëtojë jo vetëm midis planetëve brenda një sistemi diellor, por edhe midis sistemeve diellore.

E ardhmja e teorisë së Panspermisë

Aktualisht nuk ka dëshmi të forta se jeta është formuar në planetë të tjerë. Por pas çdo zbulimi astrobiologjik, bëhet më e mundshme që jeta të zbulohet së shpejti edhe përtej Tokësonë. Pyetja që mund të shtrohet është: A do të jetë kjo jetë krejtësisht e ndryshme nga çdo jetë që kemi përjetuar, apo jetë që do të rezultojnë të jenë "kushërinjtë" tanë të humbur ndërplanetarë ose ndëryjorë? E vetmja mënyrë për ta zbuluar këtë, është të vazhdohet eksplorimet.

Marrë me shkurtime nga ancient origins – bota.al



MEHMET ELEZI

VDEKJA E SOVRANIT

Njeriu përballë dukej si milingonë. Bubrrec voglan, i zi. Edhe pse mjaft i gjatë.

Ai, elefant. Madhështor, riosh. I vezullonte shpina. Hunda mund të pinte ujë në qiell, duke thithur retë.

Ti më duhesh, tha voglani i zi. Elefanti as që e përfilli. U lëshua turr kah pylli. Lisat u dridhën.

Njeriu i zi tundi kryet me gaz të idhët, hm. U ngarkua me shashka e dauille dhe iu vu pas kafshës sa një mal. Kafsha që nuk pyeste për luanët, curroi veshët. Ç'janë këto armë? Ia theri vrapit.

Njeriu i nxirë përmbropa. Dap e dup tupani. Bab-bum shashkat. Kujdes vetëm një gjë, i tha vetes. Që kafsha sa një mal të shkojë drejt vendit që di unë. Te vendi që dinte ai, kishte çelë një gropë. Të thellë, të thellë. Fshehur nën dushk të njomë. Nën bar të butë, erëmirë. Dhe gjithnjë pas kafshës sa një mal. Dap e dup, bam e bum! Të bezdisshme këto zhurma bubuzhelësh, tha elefanti. Ia futi një pordhë në turinj njeriut të zi, e përplasi tej dhe vetë u bë erë. Njeriu i zi mbeti mbrapa, por gropa që kish çelë jo. Gropa që kish

çelë përgjonte përpara. Mbuluar me gjethe e me bar plot lagshtë.

Papritmas dhe u tëhumb, elefanti u shemb në fund të gropës. Toka u trand kur ra brenda. Çoi sytë. Bregu dukej lart, tepër lart. I paarrishëm, si qielli. Ai, në fundbotë. Bërtit, kokrën e lotit sa grushti, kot.

Njeriu i nxirë kaloi përkaj. Nuk iu përgjigj vështrimit lutës të elefantit. Nuk iu përgjigj as të nesërmen. As pas pesë ditësh. Pas një jave u ndal. I uli një kovë ujë. Të pasnesërmen një kovë tjetër. Pastaj një krah degë me gjethe.

Dikur edhe një dorë bar.

Kafsha sa një mal filloi me e këqyrë njeriun vrasës si perëndi. Ti po më mban gjallë. Po, tha njeriu që e fundoi në gropë. Kush ta bëri këtë gjëmë? Kaq thellë paske rënë! Të pamundurën do të bëj, që të të nxjerr.

Dhe e nxori.

Elefanti u mbush me frymë, më i lumtur se kurrë. E kish parë vdekjen me sy, tashti dinte me e çmue jetën.

E mori me feçkë njeriun, e hipi në shpinë. Ta kam borxh, më shpëtove nga vdekja.

Njeriu i zi kish përgatitur një samar të fortë. Ia vuri në shpinë samarin e fortë. E përthekoi fort samarin e fortë. Ec!

Prej lart pikoi një e qeshur si gudulisje. Një majmun sa një kotele, i bardhë si lepurush, këqyrte prej majës së një lisi, që luhatej nëpër lirinë e qiellit.

- Hi-hi! Dhe thua jam sovran i pyllit, i tha. Ku është parë sovran me samar?

- Ik or morr!, tha elefanti. Ku di ti ç'është mirënjohja. Ky më nxori nga gropa!

- Po në gropë kush të hodhi?



RAMADAN MEHMETI

GONGU I ZGJIMIT

Po bie gongu i zgjimit mbi botën time të përgjumur.
Nuk e di sa kam fjetur e mjekra flet se muaj e ndoshta edhe vite kanë ikur.
Përgatitem për rrugë, e nis kalërimin me ditët e trishtueshme, zogjtë ma matin peizazhin në kalendar, duke mos lejuar vend-numërimin.
Lidhem me ditët që kryqëzohen në pikturën e kohës, pamja më del e kuqërremtë.
Hingëllimat nga fushëbeteja bartin drejt meje jehona historie. Nuk mund ta di se a patën kuptim të gjitha ato që bënë ata mbi ne e as ajo që pësuam ne nga ata.
Për të gjitha kurrë nuk pati arsye.
Gongu i zgjimit nuk pushon, e unë vërshoj si një valë, kapërcej mbi ditët e trishtueshme, kap një velë kohe e nisem plotësisht i zgjuar, të bëhem vetja.

ZËRI I TRISHTË

Në këtë mesnatë po skuqet terri e po hijezohen yjet. Ndoshta pse në murin e lashtë po dëgjohet fuqishëm tiktaku i një ore të re. Kujtesa se nga vjen e flet për do vite shumë të vjetra e do mplakje shumë të reja.
Ndoshta edhe koha është plakur këto vite e shekuj, sepse është disi shumë e paqëndrueshme dhe e rënduar me zvarritjen e së shkuarës e me ardhjen e së ardhmes, duke mos arritur ta krijojë assesi qetësinë e vet.
Është kohë kur nga varret dalin shpirtat, po sonte asnjë shpirt s'pipëtin. Thua se e kanë frikë atë zhurmë tiktake, tek prish heshtjen e natës e pas hpjegimit të gjatë. Kap orën t'i kthej akrepat mbrapsht e munda më shkon kot, ajo as ndalet e as tregon kohë të saktë.
Një zë i trishtë bërtet se ajo është duke matur kohën e vonuar. Një zë tjetër, edhe më i çjerrë, thotë: ruajuni se mos fillon e këlthet ajo katrahurë e trishtimi nuk na ndahet mandej.

AKULL NË TRU

Më kanë ngarkuar me peshën e një barre të padurueshme, të cilën as e sheh, as e ndien kush.
Thonë se paskam mëkatuar, se me ditë të tëra paskam dashur të orientohem humbëtirës përmes yllit tim.
Mandej, disi paskam ikur nga vetja e, lidhur me zinxhir prej kashte, paskam bekuar çdo mëkat që mund të shkruhet në pentagramin e shpirtit të zemrës.
Kam lavdëruar, apo jo përbuzjen e së përditshmes sonë të hallakatur, që na është bërë si halë në trurin tonë të vogël.
Edhe ky shesh me gurë, pa njerëz të devotshëm, është peizazh i pushtimit tonë nga vetvetja.
Në ferrin tim nuk ka vend për ferre të tjera, madje nuk e ndiej as mungesën e parajsës, sepse ajo do të tallej me mëshirë prej xhelati e me përbuzjen e së përkryerës tek ai njeriu i harruar, që kaheër është dukur në stërkalat, që sikur janë duke na u bërë akull në zemër e në tru?

PLAGËT E MOTIT TË PASHËRUESHËM

Lakoj emrin tim nëpër rase e nuk kaloj dot provimin e pjekurisë. Mas emrin e mbiemrin me fjalët e humbura të motit.
Duke kërkuar Motin e Pashërueshëm luginave të lotëve e përrallave të jetuara, shndërrohem në ajër e mbetem plotësisht i humbur.
Askund nuk më del baraspesha e asaj bote mbushur etje, shpresa e mashtrim. Me sy të përplotur ballafaqohem me murin e pakalueshëm. Ndiej dhembjen e emrit të përtypur me atë dhëmbin e vetëm në gojën e mplakur të historisë.
Ec e ec e ec për të mos e ndier ndrydhjen e shpirtit e ftohtësinë rënduese. Nuk di si ta ndal dëshpërimin tek ngjitet kurrizit tim, derisa çakejtë m'i hanë edhe opingat e grisura. Më spër-kasin në çdo hap me pështymën e tyre të pështirë e ma humbin kohën për ecje rrugëve që premtojnë.
Duan të mos kemi mundësi as të pastrojmë oborrin e fatit, i cili me shekuj ka mbetur i lënë pas dore.

O ZOT, MUND TË MOS KESH KOHË PËR FALJE

Kurrkushi më thërret të shkojmë në kurrkund. Duke qeshur më thotë se mund të ulem në stom të durimit dhe për shtatëdhjetë e shtatë vjet të kërkoj ditën pa dritë. Nuk shoh gjë në atë asgjë dhe nga maja e strumbullarit bërtas:
O, kush më ka robëruar pllajën e mendjes?!
Kush nuk ka si të më japë përgjigje për pyetjen time, ku njeriun nuk e gjen as për be.
Mund edhe ta pyesësh nga je nisur, më vjen zëri i kurrkushit, por kurrkundi është gjithkund.
Andaj vazhdo e ec rrugës deri te dhembja, po mos lëngo, se të vrasin ëndrrat. Mund ta marrësh edhe përgjigjen që me miliona vjet është duke u djegur vullkaneve të gjakut njerëzor, si mëkatarët e përjetshëm, në ditën e diel.
O Zot, sa shumë mëkatarë, sa shumë mëkatarë për t'ua falur mëkatet! Mund të mos kesh kohë për falje...
Askujt, madje as kurrkushit, nuk i bëhet vonë që pllaja e mendjes sime po digjet e kurrkundi po zgjerohet në asgjë.

DARDHA E MOÇME PRAPË DO TË LULËZOJË

Kanë ardhur e kanë shkuar kojrrilat e stinëve pa bukë. Dardhës sime të moçme i kanë ikur rrënjët thellë e më thellë në të fshehtat e tokës, e ajo përsëri nuk thahet e nuk teret, derisa degët i bëhen pre e lojërave të motmotit.
Nën ato degë, si krah bjeshke e nën do krande të kalbura, nisin lojën e tyre me erën gjethet e reja, duke synuar t'i ikin brymës e thatësisë, të shpërthejnë plot jetë e të dalin atje ku gjallëria shpërthen e lulëzimi merr përmasa pavdekësie.
Mendoj e disi mallëngjehem, kurse heshtja e zogut në mal më duket e pavend. Nuk ia di gjuhën t'i them ta përtërijë harenë brenda vetes e ta nxjerrë tingujve të këngës, qoftë edhe nga pak i trishtueshëm. Vjeshtë e hershme a pranverë e vonuar, nuk janë krejt njësoj, e as rrënjët nuk humbin nga udhëtimi thellësive, se dardha e moçme prapë do të lulëzojë.



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Agjenti i Lautaros nuk largohet nga Interi, pavarësisht ofertave nga klubet angleze

MILANO, 12 GUSHT - Agjenti i Lautaro Martinez, Alejandro Camano, këmbëngul se sulmuesi nuk largohet nga Interi pavarësisht prej ofertave nga Anglia dhe do të takohet për të diskutuar një kontratë të re javën e ardhshme. Reprzentuesi argjentinas është lidhur në mënyrë të përsëritur me Arsenalin dhe Tottenham Hotspur, si dhe Atletico Madridin, me ofertat që raportohet të sillen rreth 70 milionë eurosh. Pas shitjes së Romelu Lukakut te Chelsea për 115 milionë euro, nerazzurrit janë të vendosur të mos humbasin edhe sulmuesin e tyre tjetër. "Nga sot ai nuk po largohet nga Interi pavarësisht prej



ofertave nga Anglia. Ai është i lumtur aty dhe e do klubin. Ne do të takohemi javën e ardhshme për të diskutuar për rinovimin e

kontratës. Synimet tona janë të qarta, por gjithashtu varen prej tyre", ka thënë fillimisht agjenti Alejandro Camano për TyC Sports.

Kontrata aktuale e Lautaros zgjat deri në qershor 2023 dhe agjenti i tij deri më tani nuk ka pasur absolutisht asnjë nxitim për të

negociuar një zgjatje, duke ngritur pikëpyetje mbi të ardhmen e tij. Ka pasur sugjerime në mediat italiane se 90 milionë euro mund të ndikojnë te Interi, por tani asgjë nuk do të krijojë një ndarje. Çështja tjetër natyrisht është se Interi është në Ligën e Kampionëve, ndryshe nga Arsenali dhe Tottenham Hotspur. 'Toro' mbush 24 vjeç më vonë këtë muaj dhe u nënshkrua nga Racing Club në vitin 2018 për 25 milionë euro, ndërsa në sezonin e kaluar shëno 19 herë së bashku me 11 asistime në 48 ndeshje për klubin. Ai ishte i rëndësishëm në triumfin e Argjentinës në Copa America së bashku me Lionel Messin.


Messi mban stërvitjen e parë te PSG-ja

PARIS, 12 GUSHT - Lionel Messi ka kryer tashmë stërvitjen e parë me klubin e tij të ri, Paris Saint-Germain. Ylli argjentinas ka befasuar të gjithë duke u larguar nga Barcelona pas plot 20 vjetëve të kaluar në Camp Nou, por kjo erdhi si shkak i pamundësisë për ta rinovuar kontratën shkak i rregullave financiare të La Ligas. Messi shpejt arriti marrëveshje me francezët e PSG-së, të cilët të mërkurën konfirmuan transferimin e lojtarit. 34-vjeçari nënshkroi një marrëveshje dyvjeçare me PSG-

në këtë javë, me një opSION për një vit të tretë, që do t'i sigurojë atij një pagë vjetore prej 35 milionë eurosh, plus bonuse. Të mërkurën Messi u paraqiti nga presidenti Nasser Al-Khelaifi teksa zbuloi pritjet e mëdha për të fituar trofe me klubin nga Parc des Princes. Të enjten Messi ka mbajtur stërvitjen e parë me klubin e ri. Në disa video të publikuara Messi shihet teksa stërvit së bashku me yje të tjera si Neymar, Angel Di Maria dhe Kylian Mbappe.



Gjilani konfirmon transferimin e mesfushorit Fabjan Beqja



GJILAN, 12 GUSHT (ER) - Mesfushori shqiptar Fabjan Beqja ka kompletuar transferimin te Gjilani pas ndarjes nga Teuta e Durrësit. Beqja për më shumë se dhjetë vjet djersiti fanellën e klubit durrsak, ku fitoi çdo trofe të mundshëm në Shqipëri. Megjithatë, në verën e këtij viti

ai dhe shumë lojtarë vendosen të largohen si pjesë e një revolucioni te Teuta. Por, Beqja nuk ka qëndruar gjatë pa klub, pasi ka arritur marrëveshje dyvjeçare me Gjilani. Është vetë klubi gjilanas që ka konfirmuar transferimin e lojtarit me anë të një video në rrjetet sociale.

"Ne kemi një anëtar të ri në familjen tonë. Mirëseardhje të ngrohtë për lojtarin tonë të ri!", thuhet në njoftimin e FC Gjilani. Beqja i bashkohet Gjilanit pas transferimeve të Elton Cale, Agustin Torassa, Blerim Krasniqi, Arbër Prekazi, Albert Dabiqaj dhe Yll Hoxha.

FFK-ja ndihmon klubet e Ligës së dytë dhe Ligës së tretë

PRISHTINË, 12 GUSHT (ER) - Federata e Futbollit e Kosovës (FFK) në vazhdimësi po punon për të mirën e futbollit të Kosovës, duke u munduar që në çdo formë t'i përkrahë klubet maksimalisht. Pas arritjes së marrëveshjes për të drejtat televizive për Superligë dhe Ligën e parë si dhe finalizimin e marrëveshjes së

sponsorizimit të Ligës së parë, nga të hyrat e të cilave përfitojnë klubet e këtyre ligave, tani FFK-j do t'u dalë në ndihmë edhe ekipeve në ligat e tjera. Këtë vit FFK-ja do t'i mbulojë të gjitha shpenzimet e gjyqtarëve dhe zyrtarëve të ndeshjeve, duke i liruar nga pagesa të gjitha klubet e Ligës së dytë dhe të tretë,

duke krijuar një fond të veçantë. Në Ligën e dytë janë 16 klube, kurse në të tretën mbi 30 sosh. Federata e Futbollit të Kosovës ka theksuar se do t'i ndihmojë klubet jo vetëm në periudha të vështira sikurse kjo e pandemisë, por do të vazhdojë t'u qëndrojë afër gjithmonë.



Komuna e Gjakovës
Opština Gjakovë - Gjakova Municipality
N.P.L. "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A.
GJAKOVË
Nr. 287
Data: 12.08.2021

**N.P.L. "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A.
GJAKOVË**

KE: 0390/ 320 010
E-mail: nplsagj@gmail.com
Info: 0390/ 324 268
Web:

NUT: 81144900
Nr. TVSH: 330311853
BEK: 140200001784638

Në bazë të dispozitave të Nenit 21 të Ligjit Nr. 03/L-087 mbi Ndërmarrjet Publike, respektivisht dispozitat e Nenit 13 të Ligjit Nr. 04/L-111 për Ndryshim dhe Plotësim të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Bordi i Drejtorëve i Ndërmarrjes Publike Lokale "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Gjakovë, bazuar në mbledhjen e mbajtur më 16.07.2021 dhe vendimin Nr.294 të datës 12.08.2021 vendosi të shpall:

KONKURS

Për pozitën:

- Këshilltar/e i Përgjithshëm/Sekretar/e i Ndërmarrjes
- I Përgjigjet: Bordit të Drejtorëve
- Kohëzgjatja e Kontratës: 3 vite

Kualifikimi dhe përgatitja profesionale:

- Kandidati duhet të ketë përgatitje superiore - Fakultetin Juridik, 4 vjeçar ose me Sistem të Bolonjes 3+2.
- Të posedoj së paku pesë (5) vite përvojë profesionale.
- Të plotësoj kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1. si dhe të plotësoj kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2. pikat (d), (f), (j), (k), (l), të ligjit nr. 03/L-087 të ndërmarrjeve publike dhe plotësim ndryshimit të ligjit për ndërmarrjet publike nr. 04/L-111 neni 13;
- të ketë integritet të lartë moral e profesional.
- gradimet tjera profesionale do të kenë prioritet.
- të ketë aftësi organizative.
- njohuri të punës me kompjuter.
- njohja e gjuhëve të huaja është përparësi.
- të ketë shkathtësi në të shkruar dhe aftësi komunikimi në të folur.
- të mos jetë i/e dënuar ose nën hetime.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Organizon,koordinon dhe udhëheqë me punët e Departamentit Administrativ,
- Merr pjesë në mbledhjet e stafit udhëheqës dhe mbledhjet tjera sipas nevojës;
- Merr pjesë në krijimin e politikës afariste nga lëmia e Departamentit Ligjor;
- Koordinon punët me shërbimet tjera në kuadër të Ndërmarrjes;
- Përpilon plane mujore dhe vjetore të punëve dhe detyrave të shërbimit,
- Merr pjesë në punën e Menaxhmentit;

-Jep këshilla juridike punëtorëve të Ndërmarrjes;

-Përfaqëson Ndermarrjen në të gjitha kontestet në Gjykatat e rregullta, në të gjitha kontestet dhe kundërshtimet sipas urdhërpagesave;

-Bënë interpretimin dhe sqarimin e dispozitave e akteve normative dhe ligjeve tjera në fuqi lidhur me realizimin e administrimit;

-I zbaton punët paraprake për pranimin e punëtorëve në mardhënje pune siç janë; paraqitja e nevojës për punëtor, shpalljet, konkurset dhe veprimet tjera të nevojshme që rezultojnë nga ligjet aplikuese në Kosovë;

-Vepron si agjent i Ndërmarrjes për pranimin e njoftimeve;

-Kryen të gjitha arkivimet, publikimet dhe/ose zbulimet për autoritetet përkatëse siç mund të kërkohet me ligj;

-Mbikëqyrë mirëmbajtjen e duhur dhe azhurnimin e rregullt të uebfaqës;

Koordinon me KSHE përgatitjen e letrave (dokumente) për mbledhjet e Bordit të Drejtorëve;

-Sekretari do të mbaj procesverbalin e secilës Mbledhje të Përgjithshme dhe Bordit të Drejtorëve dhe Komisionit të Auditimit;

Si dhe detyrat tjera të cilat (mëtuje) mund të jenë të përshkruara në përshkrimin e bashkangjitur të punës ose të caktuara nga punëdhënësi.

Për punën e tij/saj i përgjigjet Bordit të Drejtorëve dhe Kryeshefit Ekzekutiv.

Paga mujore: I caktohet me Vendim të Bordit të Drejtorëve

Procedura e Konkurrimit

- Aplikacionit duhet bashkangjitur edhe këto dokumente:
- CV-në;
- Dëshminë e Shkollimit (Fakulteti Juridik);
- Dëshminë për Përvojën e Punës;
- Referenca si dhe certifikatat tjera profesionale;
- Letër motivimin;
- Deklaratën nën betim (merret nënshkruhet me rastin e dorëzimit të dokumentacionit);
- Certifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se tre (3) muaj);
- Kopjen e dokumentit të identifikimit;

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin adekuat dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

Afati dhe mënyra e aplikimit

Konkursi mbetet i hapur 30 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit me 13.08.2021 deri me datën 13.09.2021.

Aplikacioni i kompletuar mund të dorëzohet në administratën e N.P.L."Stacioni i Autobusëve"SH.A.,Gjakovë, apo përmes postës. Aplikacionet e dorëzuara pas datës së fundit dhe aplikacionet e pakompletuara nuk do të pranohen nga Bordi i Drejtorëve. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim.

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Cje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

CV

www.facebook.com/gjeipuneshpejte

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Shehrije Berisha shpall të pavlefshme diplomën e SH.M.A.P "Hysni Zajmi" Gjakovë
- ▶ Petrit Llhani shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- ▶ "DEPO STEEL" Sh.p.k. me adresë në Bresje -4, Fushë Kosovë, shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me numër: NUI 810545171.
- ▶ Fjolla Duraku nga gjakova shpall të pavlefshme diplomën e gjmnazit "Hajdar Dushi".
- ▶ Qëndrim Grezda nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e gjmnazit "Hajdar Dushi"
- ▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139



Kompania Rajonale e Ujësjellsit
"Mitrovica" SH.A.
"Rr.Liqeni", p.n. 40000 Mitrovicë-Suhodoll
E-mail; <http://kru-mitrovica.com>

Konform me funksionet dhe kompetencat që parashihen Nenit 21, lidhur me nenin 17 të Ligjit për Ndërmarrje Publike Nr. 03/L-087, nenin 13 Ligji Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative, Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve të KRU "Mitrovica"SHA, me seli në Mitrovicë-Suhodoll, në mbledhjen e mbajtur me datë 06.08.2021, vendosi të shpall ketë:

KONKURS PUBLIK

Pozita: Kryeshef Ekzekutiv i KRU "Mitrovica" Sh. A, Mitrovicë
I përgjigjet: Bordit të Drejtorëve të KRU "Mitrovica" Sh. A, Mitrovicë
Vendi: Mitrovicë-Suhodoll

Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:

Bordi i Drejtorëve dëshiron të sigurohet që të gjithë kandidatët potencial të jenë persona me integritet të njohur të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1, (ii) i plotësojnë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2, pikat (d), (f), (j), (k) dhe (l) (iii) nuk janë, ose në çfarëdo kohe gjatë periudhës tridhjetë e gjashtë (36) muajsh para datës së aplikimit nuk kanë qenë Drejtorë të Bordit të kompanisë gjegjëse dhe (iv) të Ligjit për Ndërmarrje Publike dhe kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë.

Përveç këtyre kushteve të përgjithshme kandidatët duhet të plotësojnë edhe këto kushte të veçanta:

- Kandidati duhet të ketë diplomë universitare në lëmin e administrimit të biznesit, ekonomisë, financave, inxhinierisë, apo nga fushë-veprimtaria e ndërmarrjes (së paku 4 vite studimi pas shkollës së mesme),
- diplomat duhet të jenë të nostrifikuar,
- të ketë së paku 5 vjet përvojë punë në menaxhim,
- të ketë integritet të lartë moral e profesional,
- të ketë aftësi të dëshmuara në menaxhim,
- arsimimi dhe eksperiencia në fushën e ujërave është përparësi,
- njohja e gjuhëve të huaja është përparësi,
- të mos jetë i dënuar ose nën hetime

Detyrat dhe përgjegjësit kryesore:

Funksioni dhe përgjegjësit kryesore të Kryeshefit ekzekutiv të përcaktuara me Statutin e kompanisë:

Kryeshefi Ekzekutiv i Kompanisë (KSHE) do të ketë autoritet për të lidh kontratë për Kompaninë, në pajtueshmëri me statutin, këto akte Ligjore dhe ligjin, duke iu nënshtuar vetëm kufizimeve të përcaktuara nga Bordi i Drejtorëve sipas Statutit të Kompanisë .

Biznesi, detyrat dhe organizimi i kompanisë duhet të kryhet sipas direktivave, mbikëqyrjes dhe përgjegjësisë së KSHE, në pajtueshmëri me statutin dhe aktet Ligjore të kompanisë dhe vendimeve të Bordit të Drejtorëve. Të gjitha çështjet në lidhje me biznesin e Kompanisë të cilat nuk janë përgjegjësi të Mbledhjes së Përgjithshme, të Bordit të Drejtorëve, Komisionit të Auditimit apo Zyrtarit të Auditimit të Brendshëm do të vendosen nga apo sipas direktivave dhe përgjegjësitë së KSHE.

KSHE do të ketë autoritet të punësoj apo të largoj nga puna zyrtarët dhe stafin e kompanisë, përveç Zyrtarit Kryesor Financiar, Zyrtarin e auditimit të brendshëm dhe Sekretarin e Kompanisë dhe të delegoj autoritetin e tillë tek zyrtarët e tjerë dhe anëtarët e tjerë. Përfshirë edhe : Zyrtarin Kryesor Financiar, Zyrtarin e Auditimit të Brendshëm, Sekretarin dhe cilitdo zyrtarë tjetër që Bordi i Drejtorëve në mënyrë specifike mbanë të drejtat të punësoj apo të largoj, ky mund të punësohet apo të largohet vetëm nga Bordi i Drejtorëve.

KSHE gjithashtu duhet të:

Këshillojë dhe asistoj Bordin e Drejtorëve në përcaktimin e strategjisë së kompanisë si dhe planet e saja strategjike afatgjata;

Propozoj Bordit të Drejtorëve kandidat të përshtatshëm për punësim si ZKF dhe Sekretarë, duke sugjeruar së paku dy (2) persona për secilën pozitë;

Dorëzon, sipas përgjegjësisë e tij Bordit të Drejtorëve drafte të dokumenteve që parashikohen me Statut të Kompanisë;

T'i ofroj kurdo që të jetë e nevojshme, dhe së paku një herë në tre muaj, Bordit të Drejtorëve raporte për transaksionet kryesore të ndërmarrja nga kompania dhe për vendimet kryesore të ndërmarrja nga menaxhmenti në lidhje me udhëheqjen e biznesit dhe të punëve të Kompanisë;

T'i dorëzoj, nën përgjegjësinë e tij/saj, Bordit të Drejtorëve dokumente, letra dhe informacione në lidhje me të gjitha çështjet e përfshira në agjendën e mbledhjeve të tij;

T'i propozoj Bordit të Drejtorëve shenja adekuate për matjen e performancës së kompanisë, si dhe t'i ofroj Bordit rregullisht- e së paku çdo tre muaj - raportet e matjes së performancës së Kompanisë kundrejt shenjave të tilla;

Të themeloj dhe rishikoj strukturën organizative të kompanisë, si dhe alokimin e fuqisë vendim-marrëse të kompanisë, si dhe të fuqisë të ndërlidhjes në mes të udhëheqësve dhe të punësuarve në kompani;

T'i ofroj Komisionit të Auditimit të gjitha informatat dhe asistencën që mund të kërkojë;

T'i ofroj Zyrtarit të Auditimit të Brendshëm të gjitha informatat dhe asistencën që mund të kërkojë nga ky i fundit; dhe

Të marrë pjesë në të gjitha Mbledhjet e Përgjithshme.

Ndërsa detyrat specifike, autoritetet dhe përgjegjësit e KE janë:

Të menaxhojë dhe organizojë përgatitjen e planeve pasuese dhe propozimet si dhe prezantimin e tyre në Bordin e Drejtorëve:

Përgatitë propozimin për tarifa të Kompanisë për ARRU-në,

Përpilon Planin ekonomik bazuar në principet e shpenzimeve. Planifikimi duhet të përmbajë të hyrat e pritura, shpenzimet e bëra dhe planifikimin vjetor të investimeve dhe burimin e financimit, duke përfshirë huamarrjen, nëse është e mundur.

Planin e biznesit, i cili ka nëndarjen në tepricat vjetore (bilanci pozitiv) dhe planifikimi i parashikuar i menaxhimit të aseteve. Skema organizative e të punësuarve të jetë pjesë e planit të biznesit.

Planin e parashikuar pesë vjeçar të financave. Si bazë për planin pesë vjeçar të financave, duhet të planifikohet (skicohet) programi i investimeve. Plani afatgjatë i financave duhet të prezantohet në Bordin e Drejtorëve së bashku me planin e biznesit. Plani financiar duhet të jetë i punuar në baza vjetore.

Raporti vjetor i biznesit përfshirë edhe raportin vjetor të llogarive Njesisë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike.

Propozimet tjera të bëra nga Bordi i Drejtorëve ose të bazuara në vendimet e KSHE.

Të organizoj dhe planifikojë studime të ndryshme dhe të planifikoj aktivitetet e nevojshme me qëllim të funksionimit të suksesshëm të kompanisë. Kjo mund të përfshijë planifikimin e investimeve, specifikat teknike, dokumentet e ofertave, prokurimit, inspektimit, indeksin tarifor, kontrollin e kualitetit të shërbimeve të ujit dhe kanalizimit, menaxhimin e resurseve njerëzore, administrimin financiar, aktivitetet ligjore, marrëdhëniet publike, informimin teknologjik etj.

Të menaxhojë dhe mbikëqyrë planifikimin dhe zhvillimin detal të strukturës organizative të kompanisë.

Në bazë të aprovimit të Bordit të Drejtorëve, të caktojë menaxher shtesë funksional apo gjeografik të kompanisë, nëse kjo ndarje e përgjegjësisë do të përmirësojë veprimtarinë e Kompanisë.

Të konfirmojë përshkrimet detale të detyrave të punës të Drejtorit Financiar dhe Sekretarit, Aprovimi final i përshkrimit të punëve do të bëhet nga ana e Bordit të drejtorëve.

Të bëjë nominimin (propozimin) emërimin e stafit menaxherial (Drejtorit financiar dhe Sekretarit të kompanisë) për aprovim në/nga Bordi i Drejtorëve.

Të diskutojë me stafin menaxherial për planet e punës vjetore të tyre dhe qëllimet e punës dhe përcjellë realizimin e tyre.

KSHE i Kompanisë ka obligim mirëbesimi ndaj Kompanisë. Aty ku duhet, kjo detyrë mirëbesimi përfshin detyrat si vijon:

- (a) të veprojë në mirëbesim për të mirën e Kompanisë;
- (b) të ushtrojë kompetencat e dhëna në përputhje me interesin më të mirë të Kompanisë;
- (c) të kushtojë vëmendjen e duhur çështjeve mbi të cilat merr vendim;
- (d) të shmangë dhe të bëjë të ditur konfliktet ekzistuese dhe të mundshme të interesit mes interesave të tij vetjake dhe atyre të Kompanisë;
- (e) të ushtrojë kujdes dhe aftësi të arsyeshme në kryerjen e këtyre funksioneve; dhe
- (f) të trajtojë si konfidenciale gjithë informacionet e marra gjatë kryerjes së detyrës.

Raporton para: **Bordit të Drejtorëve**

Paga: Në pajtim me politikën e kompensimit të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve.

Procedura e aplikimit:

Aplikacioni duhet bashkangjitur edhe këto dokumente:

- CV-ja (Biografia),
- Kopja e letërnjoftimit,
- Letër motivimi,
- Deklarata nën betim
- Diplomën e fakultetit – kopje e noterizuar,
- Dëshminë nga gjykata kompetente që nuk është nën hetime, jo më të vjetër se 6 muaj
- Dëshmitë e përgatitjes profesionale,
- Dëshmitë e eksperiencës në punë

Aplikacionet mund të merren në drejtorinë e Kompanisë ose në ueb -faqen e Kompanisë . Aplikacionet dhe dokumentet përcjellëse duhet të dorëzohen të mbyllura në Zyren e Administratës.

Konkursi do të jetë i hapur 30 ditë nga dita e publikimit.

KRU "Mitrovica" Sh.A. Mitrovicë-Suhodoll.



Regionalno Vodovodno Preduzeće
 "Mitrovica" d.d.
 "Ul. Likeni", b.b. 40000, Mitrovica-
 Suhodol E-mail; <http://kru-mitrovica.com>

U skladu sa funkcijama i nadležnostima predviđenim članom 21., u vezi sa članom 17. Zakona o Javnim Preduzećima br. 03 / L-087, član 13 Zakon br. 04 / L-111 o izmenama i dopunama Zakona br. 03 / L-087 o Javnim Preduzećima i Etičkom kodeksu i korporativnom upravljanju, Privremeni Odbor direktora RKV "Mitrovica" DD, sa sedištem u Mitrovici-Suhodol, na sastanku održanom 06.08.2021, odlučio je da objavi sledeće:

JAVNI KONKURS

Pozicija: Glavni izvršni direktor RKV "Mitrovica" D. D,
Mitrovica Odgovara: Odbor Direktora RKV "Mitrovica" D.
D, Mitrovica Mesto: Mitrovica-Suhodol

Potrebni uslovi i kvalifikacije:

Upravni odbor želi da osigura da svi potencijalni kandidati budu osobe priznatog integriteta koje ispunjavaju uslove za kvalifikaciju iz člana 17.1, (ii) ispunjavaju kriterijume za nezavisnost iz člana 17.2, tačke (d), (f), (j), (k) i (l) (iii) nisu, niti u bilo kom trenutku tokom perioda od trideset šest (36) meseci pre datuma podnošenja zahteva nisu bili direktori odbora dotičnog preduzeća, i (iv) Zakon o javnim preduzećima i imaju potrebno stručno iskustvo i obrazovanje potrebno za dotično radno mesto.

Pored ovih opštih uslova, kandidati moraju ispunjavati i sledeće posebne uslove:

- Kandidat mora imati visoku stručnu spremu iz oblasti poslovne administracije, ekonomije, finansija, inženjeringa ili iz oblasti delatnosti preduzeća (najmanje 4 godine studija nakon srednje škole),
- diplome moraju biti nostrifikovane,
- da imaju najmanje 5 godina radnog iskustva u menadžmentu,
- da imaju visok moralni i profesionalni integritet,
- imaju dokazane upravljačke sposobnosti,
- obrazovanje i iskustvo u oblasti voda su prioritet,
- poznavanje stranih jezika je prioritet,
- da nije osuđivan ili pod

istragom Glavne dužnosti i odgovornosti:

Glavne funkcije i odgovornosti glavnog izvršnog direktora definisane statutom kompanije:

Glavni izvršni direktor Kompanije (GID) imaće ovlašćenje da zaključi ugovor za Kompaniju, u skladu sa statutom, ovim pravnim aktima i zakonom, podložno samo ograničenjima koja je odredio Odbor direktora u okviru Kompanije Statut.

Poslovi, dužnosti i organizacija kompanije moraju se obavljati u skladu sa direktivama, nadzorom i odgovornošću GID -a, u skladu sa statutom i pravnim aktima kompanije i odlukama Odbora direktora. O svim pitanjima koja se odnose na poslovanje Društva, a koja nisu u nadležnosti Skupštine,

Upravnog odbora, Revizorskog odbora ili Službenika za unutrašnju reviziju, odlučiće se ili prema direktivama i odgovornostima DIK -a.

GID će imati ovlašćenje da angažuje ili otpušta službenike i osoblje Kompanije, osim glavnog finansijskog službenika, službenika za unutrašnju reviziju i sekretara kompanije, i da prenese ta ovlašćenja na druge službenike i druge članove. Uključujući: glavnog finansijskog službenika, službenika za unutrašnju reviziju, sekretara i bilo koje drugo službeno lice koje Upravni odbor izričito zadržava pravo da zaposli ili ukloni, ovo može angažovati ili ukloniti samo Upravni odbor.

GID takođe treba:

Da Savetuje i pomaže Odboru direktora u utvrđivanju strategije kompanije, kao i njenih dugoročnih strateških planova;

Odboru direktora predložiti odgovarajućeg kandidata za zapošljavanje kao finansijskog direktora i sekretara, predlažući najmanje dve (2) osobe za svaku poziciju;

U skladu sa svojim odgovornostima, Odboru direktora dostavlja nacрте dokumenata predviđenih Statutom kompanije;

Dostavlja izveštaje Odboru direktora kad god je to potrebno, a najmanje jednom u tri meseca, o

ključnim transakcijama koje je preduzelo Preduzeće i o ključnim odlukama uprave u vezi sa poslovanjem i poslovanjem Društva;

Podnosi, na svoju odgovornost, Odboru direktora dokumente, pisma i informacije u vezi sa svim pitanjima koja su uključena u dnevni red njegovih / njenih sastanaka;

Da Odboru direktora predloži odgovarajuće znakove za merenje učinka društva, kao i da Odboru redovno

- a najmanje svaka tri meseca - dostavlja izveštaje o merenju učinka Društva prema takvim znacima; Osnivati i preispitati organizacionu strukturu preduzeća, kao i raspodelu moći odlučivanja u preduzeću, kao i moć povezivanja između lidera i zaposlenih u preduzeću;

Dostaviti Odboru za reviziju sve potrebne informacije i pomoć;

Dostaviti službeniku za unutrašnju reviziju sve informacije i pomoć koja se od njih može zahtevati; I Prisustvujte svim opštim sastancima.

Dok su posebni zadaci, ovlašćenja i odgovornosti EK:

Da upravlja i organizuje pripremu sledećih planova i predloga, kao i njihovo predstavljanje Upravnom odboru:

Priprema predlog tarife Kompanije za ARRUI,

Sastavlja Ekonomski plan zasnovan na principima rashoda. Planiranje bi trebalo uključivati očekivane prihode, nastale rashode i godišnje planiranje ulaganja i izvor finansiranja, uključujući zaduživanje, ako je moguće.

Poslovni plan, koji ima podjelu na godišnje viškove (pozitivno stanje) i planirano planiranje upravljanja imovinom. Organizaciona šema zaposlenih da bude deo poslovnog plana.

Predviđen petogodišnji finansijski plan. Kao osnovu za petogodišnji finansijski plan, investicioni program treba planirati (skicirati). Dugoročni finansijski plan treba predstaviti Upravnom odboru zajedno sa poslovnim planom. Finansijski plan treba pripremati na godišnjoj osnovi.

Godišnji izveštaj o poslovanju, uključujući godišnji izveštaj Jedinice za politiku i nadgledanje javnih preduzeća.

Ostali predlozi koje je dao Upravni odbor ili na osnovu odluka GDI -a.

Organizovanje i planiranje različitih studija i planiranje neophodnih aktivnosti za uspešno poslovanje kompanije. To može obuhvatiti planiranje investicije, ulaganja, tehničke specifikacije, tendersku dokumentaciju, nabavku, inspekciju, indeks tarifa, kontrolu kvaliteta usluga vodosnabdijevanja i kanalizacije, upravljanje ljudskim resursima, finansijsku administraciju, pravne aktivnosti, odnose s javnošću, tehnološke informacije itd.

Upravlјati i nadzirati detaljno planiranje i razvoj organizacione strukture preduzeća.

Na osnovu odobrenja Odbora direktora, imenuje dodatni funkcionalni ili geografski menadžer kompanije, ako se ova podela odgovornosti ce poboljšati delatnost Kompanije. Da potvrdi detaljne opise poslova glavnog finansijskog direktora i sekretara, Upravni odbor će konačno odobriti opis posla.

Predloži (predložiti) imenovanje rukovodećeg osoblja (finansijskog direktora i sekretara kompanije) na odobrenje od strane / od strane Upravnog odbora.

Raspravljati sa rukovodećim osobljem o njihovim godišnjim planovima rada i radnim ciljevima i pratite njihovu implementaciju.

GDI Kompanije ima obavezu poverenja prema Kompaniji. Tamo gde je potrebno, ovaj zadatak poverenja uključuje sledeće zadatke:

- (a) postupati u dobroj veri za dobro Kompanije;
- (b) vrši ovlašćenja data u skladu sa najboljim interesima Kompanije;
- (c) posvetiti dužnu pažnju pitanjima o kojima odlučuje;
- (d) izbegavati i obelodanjiti postojeće i potencijalne sukobe interesa između sopstvenih interesa i interesa Kompanije;
- (e) primjenjuju razumnu pažnju i vještinu u obavljanju ovih funkcija; I
- (f) tretira kao poverljive sve podatke dobijene tokom obavljanja svojih zadataka. Izveštava pri: Upravnim Odborom

Plata: U skladu sa politikom kompenzacije koju je odobrio Upravni odbor.

Aplikacija postupak:

Uz prijavu morate priložiti sledeće dokumente:

- CV (biografija),
- Kopija lične karte,
- Motiv propratno pismo, Rata Affidavit
- Diploma Fakultetska diploma - overena kopija,
- Dokazi nadležnog suda koji nisu u istrazi, ne stariji od 6 meseci
- Dokazi o stručnom usavršavanju,
- Dokazi o radnom iskustvu

Prijave se mogu dobiti u imeniku Kompanije ili na veb stranici Kompanije. Prijave i propratna dokumentacija moraju se predati zatvoreni Upravi za administraciju.

Konkurs će biti otvoren 30 dana od dana objavljivanja.

RKV „Mitrovica“ dd. Mitrovica - Suhodoll.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales




PASHTETË PULE

MEKA
HALAL FOOD

gluten
free



100% mish pule



cilësi e garantuar

pa konservues